



Infrakos

RAPORTI (JANAR-MARS) 2022



Fushë Kosovë

Maj 2022

Përmbajtja

Aktivitetet kryesore dhe struktura organizative e INFRAKOS-it	2
1.1 Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it	3
1.2 Bashkëpunimi ndër rajonal	5
1.3 Struktura organizative e INFRAKOS-it.....	5
Performanca afariste e INFRAKOS-it.....	7
2.1 Departamenti i komunikacionit.....	8
2.2 Departamenti i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore	11
2.3 Departamenti i veprimtarisë elektroteknike	16
2.4 Zyra e planifikimit dhe zhvillimit	19
2.5 Departamenti i administratës	20
2.6 Departamenti i MP, SHMP & IT	23
2.7 Departamenti për pronë dhe standarde.....	24
2.8 Departamenti i prokurimit	25
2.9 Kontrollori i brendshëm	26
Performanca financiare e INFRAKOS-it	27
3.1 Performanca financiare e INFRAKOS-it	28
3.2 Të hyrat.....	29
3.3 Shpenzimet	30
3.4 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve	30
3.5 Transaksionet financiare	30
Procedurat gjyqësore	32
5.1 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it	33
Ngritja e performancës.....	34
6. 1 Sugjerimet për ngritjen e performancës.....	35

Aktivitetet kryesore dhe struktura organizative e INFRAKOS-it



1. 1 Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it

Vitin 2022 INFRAKOS-i e ka filluar me shumë sfida të cilat falë angazhimeve maksimale e të gjithë stafit janë tejkaluar dhe po tejkalohen me sukses. Por problemi tanimë i vazhdueshëm i ndërlidhur me gjendjen tejet të vështirë financiare me dhe pa fajin e INFRAKOS-it na ka përcjellë edhe në tremujorin e parë të vitit. Si zakonisht edhe në këta tre muaj, prioriteti kryesor ka qenë i orientuar në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore ashtu që të mundësohet qarkullimi i trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave pa problem dhe në mënyrë të sigurt.

Vlen të potencohet se gjatë këtij tremujori është bërë një punë e madhe dhe e vazhdueshme në realizimin e projektit të rehabilitimit dhe modernizimit të Linjës së 10-të Hekurudhore, përfshirë këtu të gjitha nënprojektet përbërëse të projektit në fjalë.

Departamentet dhe sektorët tjerë mbështetës janë angazhuar maksimalisht rreth financave, patundshmërisë, planifikim zhvillimit dhe ngritjeve të kapaciteteve njerëzore.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit dhe bashkërenditjes së veprimeve me institucionet përgjegjëse të shtetit lidhur me MSA-në, Programin e Reformave Ekonomike, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, realizimit të detyrave të parapara me planin e veprimit të Komitetit Teknik mbi Hekurudhat të Komunitetit të Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke plotësuar dhe dorëzuar me kohë të gjitha raportet, informatat dhe të dhënat e ndryshme të kërkuara nga institucionet përkatëse.

Gjatë këtij tremujori janë hartuar, miratuar dhe dorëzuar me kohë raporti vjetor për vitin 2021, raporti mbi kënaqshmërinë e klientëve, raportet mujore, si dhe hartimi i Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2023 që paraqet dokumentin kryesor të kompanisë për përcaktimin e kushteve mbi ofrimin e shërbimeve për operatorët e transportit hekurudhor dhe pagesat e qasjes në binarë.

1.1.1 Raportimi

Njëri ndër obligimet e shumta të INFRAKOS-it është i ndërlidhur me raportimin e rregullt për bordin e drejtorëve dhe institucionet përgjegjëse shtetërore lidhur me gjendjen e kompanisë dhe zhvillimet e ndodhura për periudha të caktuara kohore.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti INFRAKOS-i ka hartuar Raportin vjetor për vitin 2021 dhe i njëjti pas miratimit nga Bordi është dërguar në Njësinë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. Përveç raportit vjetor të vitit 2021, gjatë kësaj kohe janë hartuar dhe dorëzuar edhe raportet mujore për muajin janar dhe shkurt të vitit 2022, duke përmbytur kështu edhe obligimet e raportimit për periudhën tremujore të këtij viti.

Sa i përket raportimit vlen të përmendet edhe hartimi dhe dorëzimi i raportit mbi kënaqshmërinë e klientëve, raport ky tejet i rëndësishëm përmes të cilit përcaktohet dhe vlerësohet puna e kompanisë tonë sidomos në sektorët të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme, duke filluar nga sektori i komunikacionit për ofrimin e shërbimeve të organizimit të trafikut të trenave, ofrimin e shërbimeve tjera për operatorët e transportit hekurudhor, e deri te ofrimi i shërbimeve në terminalin e mallrave. Më pastaj vjen ofrimi i shërbimeve të cilat i bënë sektori i patundshmërisë dhe kanë të bëjnë me dhënie me qira të banesave të INFRAKOS-it, lokaleve të ndryshme dhe pronës tjetër të kompanisë. Me një fjalë, raporti i kënaqshmërisë tregon se gjatë vitit 2021 ka pasur një ngritje dhe përmirësim të shërbimeve të cilat i ofron INFRAKOS-i, e kjo tregon për angazhimin e shtuar të kompanisë karshi klientëve tonë.

1.1.2 Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2023

Përveç detyrave të përditshme në mirëmbajtje dhe organizim të transportit hekurudhor, gjatë tremujorit të parë të këtij vitit është bërë edhe hartimi i njërit nga dokumentet më të rëndësishme të kompanisë: Ekspozeu i Rrjetit për vitin 2023. Ky Ekspoze është përpiluar në bazë të kreut IV të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, respektivisht nenit 55, 61, 62, 64 dhe 65 të këtij ligji, si dhe Udhëzimeve Administrative të Ministrisë së Infrastrukturës nr. 1991/13 dhe atë me nr. 1992/13 të datës 28.06.2013.

E veçanta e këtij Ekspozeu është se i njëjti është hartuar në pajtim me propozimet e ekspertëve të jashtëm të EGIS BCOM të cilët të financuar nga BERZH-i gjatë vitit 2018 e kanë realizuar projektin mbi TAC & AMP (Pagesat e Qasjes në Binarë & Planin mbi Menaxhimin e Aseteve) për INFRAKOS-in.

Vlen të përmendet se INFRAKOS-i ua ka dërguar Ekspozeun e Rrjetit 2023 të gjitha palëve të interesit dhe bazuar në nenin 58 të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, ka filluar procesin e konsultimit me të gjitha palët e interesit të parapara me këtë ligj.

1.1.3 Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit të Terminalit të Mallrave për vitin 2023

Gjatë këtij tremujori është bërë edhe hartimi i Ekspozeut të Rrjetit mbi Terminalin e Mallrave për vitin 2023 në të tria gjuhët dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen e kompanisë. Me këtë ekspoze bëhet përcaktimi i kushteve dhe tarifave mbi ofrimin e shërbimeve në Terminalin e Mallrave në Miradi për të gjitha palët e interesit të cilat dëshirojnë ta shfrytëzojnë këtë terminal për transportin e mallrave.

1.1.4 Linja e 10 (dhjetë) hekurudhore

Gjatë këtij tremujori ka vazhduar puna në realizimin e projektit të rehabilitimit të linjës së 10 hekurudhore (Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Ndër punët dhe detyrat e realizuara gjatë këtij tremujori vlen të përmenden:

- Ka vazhduar rehabilitimi i pjesës jugore (fazës së parë) të kësaj linje hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), por përkundër kërkesave tona të vazhdueshme dhe takimeve të shumta me punë kryesin, vëllimi i punëve të kryera nuk ka qenë i kënaqshëm;
- Gjatë këtij tremujori ka vazhduar puna për sigurimin e kushteve të kërkuara për fillimin e rehabilitimit të fazës së dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë).
- Gjatë kësaj kohe ekspertët e INFRAKOS-it së bashku me ata të BERZH-it dhe BEI-së kanë punuar edhe në sigurimin e mjeteve financiare për publikimin e tenderit për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënë instalimin e sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikimit për fazën (1+2).
- Një punë relativisht e mirë është bërë edhe në hartimin e Projekt dizajnit Detaj Teknik për rehabilitimin dhe modernizimin e fazës së tretë (Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë). Ky projekt dizajn është kah realizohet nga IPF9 dhe Konzorciumi Hill International. Projekti pritet të kryhet deri kah muaji qershor 2023.

1.1.5 Linjat tjera hekurudhore

Gjatë këtij tremujori ekspertët e INFRAKOS-it kanë bërë edhe hartimin e Termave të Referencës për Projekt dizajnin e linjës hekurudhore (Fushë Kosovë – Klinë – Pejë) si dhe të linjës hekurudhore (Klinë – Prizren). Këto terma i janë dërguar Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, andaj mbetet që të shihet mundësia e gjetjes së fondeve për realizimin e dizajneve për të dyja linjat hekurudhore.

1.1.6 Mirëmbajtja e infrastrukturës

Gjatë këtij tremujori të gjithë sektorët e INFRAKOS-it kanë pasur një angazhim të veçantë në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, sidomos në kohën me temperatura të ulëta gjatë dimrit, ashtu që komunikacioni hekurudhor të zhvillohet pa problem. Angazhimi i të gjithë punonjësve për realizimin e detyrave të parashtruara ka qenë shumë i madh dhe të gjitha kërkesat e operatorëve të transportit (TRAINKOS dhe RAILTRANS) për trena të jashtëzakonshëm të udhëtarëve dhe të mallrave janë realizuar menjëherë. Përveç aktiviteteve të përmendura më lartë, janë zhvilluar edhe një numër i madh i aktiviteteve tjera të ndërlidhura me mirëmbajtjen, zhvillimin, funksionimin më të mirë dhe në tërësi për ngritjen e performancës së INFRAKOS-it. Vlen të ceket se gjatë këtij tremujori ka pasur mbyllje të linjës hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit) për shkak të ekzekutimit të punëve në rehabilitimin gjeneral të këtij segmenti hekurudhor, mirëpo të gjitha pengesat janë tejkaluar pa ndonjë problem dhe me mirëkuptim të operatorëve tanë të transportit hekurudhor.


1.2 Bashkëpunimi ndër rajonal

Një punë e madhe gjatë këtyre tre muajve është bërë edhe në bashkëpunimin e INFRAKOS-it me vendet e rajonit, kështu që në drejtim të realizimit të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet menaxherëve të Infrastrukturës të Ballkanit Perëndimor të nënshkruar në Beograd në nëntor të vitit 2021, me datën 09.02.2022 në Shkup të Maqedonisë së Veriut është mbajtur takimi i parë i Rrjetit Hekurudhor të Menaxherëve të Infrastrukturës të Ballkanit Perëndimor (RIMN WB), në të cilin takim është bërë rregullorja e punës dhe janë caktuar fushat e bashkëpunimit ndërmjet Menaxherëve të Infrastrukturës. Takimi i radhës pritet të mbahet në muajin maj 2022, ku do të ndërmerren aktivitetet për veprime konkrete në fushën e bashkëpunimit.

1.3 Struktura organizative e INFRAKOS-it


Struktura organizative e INFRAKOS-it në fund të tremujorit të parë të këtij vitit nuk ka pësuar ndonjë ndryshim dhe është e njëjtë me strukturën organizative të tremujorit paraprak. Struktura e re organizative e INFRAKOS-it e paraqitur në figurën e mëposhtme është miratuar nga Bordi, por do të hyjë në funksion vetëm pasi që të bëhet hartimi dhe miratimi i Rregullores mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe asaj mbi pagat.

Vlen të përmendet se kjo strukturë organizative është dukshëm më e thjeshtë dhe më e qartë sesa struktura paraprake, por po ashtu vlen të potencohet se të gjitha funksionet INFRAKOS-it janë të pasqyruara në këtë strukturë andaj edhe funksionimi dhe menaxhimi i kompanisë do të bëhet më i lehtë



INFRAKOS-i gjatë tremujorit të parë 2022 sa i përket numrit e të punësuarve ka pasur ndryshime për shkak pensionimit të një numri të punëtorëve, kështu që në fund të muajit mars INFRAKOS SH.A ka pasur 262 punëtorë të rregullt dhe ju kanë shtuar edhe 6 anëtarë të Bordit, duke arritur gjithsej 268 të punësuar.

Performanca afariste e INFRAKOS-it



2.1 Departamenti i komunikacionit

Departamenti i komunikacionit gjatë muajve (janar – mars) 2022 vazhdimisht është marrë me ofrimin e shërbimeve për nevoja të operatorëve të transportit hekurudhor (TRAINKOS-it dhe RAILTRANS-it), veçanërisht me përcjelljen dhe rregullimin e lëvizjes së sigurt të trenave, qoftë atyre të udhëtarëve apo të mallrave.

Departamenti i komunikacionit ka punuar me një angazhim 24 (njëzetekatër) orësh për rregullimin dhe mbikëqyrjen e komunikacionit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave, duke u kujdesur që çdo gjë të jetë në nivelin e duhur dhe të zbatohet me përpikëri orari i lëvizjes së trenave.

Falë angazhimeve maksimale, gjatë këtyre tre muajve nuk kemi pasur asnjë vonesë apo anulim të qarkullimit të trenave për shkak të këtij departamenti. Për më tepër, çdo kërkesë e operatorëve të transportit hekurudhor TRAINKOS-it apo RAILTRANS-it për futjen në komunikacion të trenave të cilët nuk kanë qenë të paraparë me orar të lëvizjes së trenave dhe për të cilët janë kërkuar trase të jashtëzakonshme, është realizuar menjëherë.

Angazhimet tjera të Departamentit të komunikacionit janë paraqitur si në vijim:

- Udhëheqja e të dhënave bazë për lëvizjen e trenave (numrin e trenave të udhëtarëve, mallrave, rastet e jashtëzakonshme, të hyrat nga qasja në binarë, etj.);
- Shkollimi i rregullt sipas rregulloreve përkatëse i stafit ekzekutiv;
- Kontrollimi teknik i ndërrueseve së bashku me departamentet tjera;
- Kontrollimet teknike të stacioneve hekurudhore;
- Përcjellja e fazës testuese për katër vendkalime të mbrojtura me barriera automatike në linjën Fushë Kosovë-Pejë. Licencimi i këtyre vendkalimeve pritet nga ARH-ja.
- Nga komisioni është lëshuar në fazë testuese prej 6 muajve vendkalimi në km 80+985 në hyrje të stacionit Pejë.

Vlen të përmendet se linja hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit, nga stacioni Miradi deri tek Kufiri me Maqedoninë Veriore ka vazhduar të jetë e mbyllur për shkak të ekzekutimit të projektit.

Sfidë e këtij departamenti mbetet mungesa e stafit ekzekutiv për rregullimin e komunikacionit hekurudhor.

2.1.1 Numri i trenave

Prioriteti numër një i këtij departamenti gjatë këtij tremujori ka qenë organizimi i qarkullimit të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave nëpër linjat hekurudhore.

Në tabelat vijuese janë paraqitur të dhënat mbi numrin e trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave të cilët kanë qarkulluar në tremujorin e parë të këtij viti, duke e bërë krahasimin e tyre me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2021.

Tabela 1 Numri i trenave të udhëtarëve gjatë TM1 2022

Krahasimi i trenave	Trenat e udhëtarëve			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2022	540	540	0	0
Viti 2021	537	537	0	3
Diferenca (2022 - 2021)	3	3	0	-3

Tabela 2 Numri i trenave të mallrave gjatë TM1 2022

Krahasimi i trenave	Trenat e mallrave			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2022	9	4	5	599
Viti 2021	710	289	421	149
Diferenca (2022-2021)	-701	-285	-416	450

Nga tabelat e mësipërme shihet se numri i trenave të udhëtarëve në tremujorin e parë të këtij viti është më i madh në krahasim me numrin e trenave të udhëtarëve e të njëjtës periudhë të vitit paraprak.

Sa i përket numrit të trenave të mallrave në periudhën kohore janar – mars të këtij viti nuk ka pasur transport vendor e as ndërkombëtar, përveç disa trena për nevoja të KFOR-it dhe të GCF-ës, prandaj siç shihet edhe në tabelën e mësipërme numri i trenave të mallrave është shumë i vogël në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

2.1.2 Numri i aksidenteve

Një brengë kryesore dhe njëri ndër problemet më të mëdha të këtij departamenti paraqesin rastet e jashtëzakonshme, apo aksidentet të cilat ndodhin në linjat tona hekurudhore. Në tabelën vijuese janë paraqitur aksidentet të cilat kanë ndodhur në tremujorin e parë të këtij viti duke i krahasuar ato me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Tabela 3 Rastet e jashtëzakonshme TM1 2022

Rastet e jashtëzakonshme	Numri total i aksidenteve	Vlera e dëmeve materiale	Numri i personave të lënduar	Numri i personave të vdekur
Viti 2022	2	0.00 €	2	0
Viti 2021	6	1 290.00 €	7	0
Diferenca (2022 - 2021)	-4	-1 290.00 €	-5	0

Nga tabela shihet se kemi pasur gjithsejtë dy raste të jashtëzakonshme. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 shihet se kemi ulje të numrit të këtyre rasteve. Në këto aksidente nuk ka pasur persona të vdekur, por kanë qenë dy persona të lënduar. Vlen të ceket se të gjitha rastet e jashtëzakonshme janë të trajtuara nga komisioni profesional i përbashkët i INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it, si dhe Policia e Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet se asnjëri prej rasteve të jashtëzakonshme të përmendura më lartë nuk ka ardhur si pasojë e INFRAKOS-it.

2.1.3 Shërbimi i qasjes në binarë

Shërbimi i qasjes në rrjet ka bërë me sukses përcjelljen e vazhdueshme të qarkullimit e të gjitha mjeteve lëvizëse nëpër rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it duke bërë llogaritjen dhe faturimin e pagesave të qasjes në binarë dhe e të gjitha shërbimeve tjera shtesë të cilat i ka ofruar INFRAKOS-i për operatorin e transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS. Në tabelat vijuese është dhënë krahasimi i të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2022 me tremujorin e parë të vitit 2021 për operatorin TRAINKOS dhe atë RAILTRANS.

Tabela 4 Të hyrat e TRANKOS-it në K1 2022

Periudha kohore	Të hyrat nga trenat e udhëtarëve	Të hyrat nga trenat e mallrave	Të hyrat nga trenat jo të rregullt – ad hok	Të hyrat nga shërbimet tjera	Të hyrat totale
(Janar – mars) 2022	38 521.80	30.46	0.00	4 085.35	42 637.61
(Janar – mars) 2021	38 293.64	19 594.26	29 807.12	25 017.15	112 712.17
Diferenca (2022 – 2021)	228.16	-19 563.80	-29 807.12	-20 931.80	-70 074.56

Tabela 5 Të hyrat e RAILTRANS-it në K1 2022

Periudha kohore	Të hyrat nga trenat e mallrave	Të hyrat nga trenat jo të rregullt – ad hok	Të hyrat nga shërbimet tjera	Të hyrat totale
(Janar – mars) 2022	0.00	0.00	175.40	175.40
(Janar – mars) 2021	52.11	5.56	503.58	561.25
Diferenca (2022 – 2021)	-52.11	-5.56	-325.18	-385.85

Nga tabelat e mësipërme shihet se në tremujorin e parë të këtij viti ka pasur një rënie të të hyrave nga Operatori i Transportit – TRANKOS për 70,074.56 €, sikurse edhe një rënie e të hyrave nga operatori privat RAILTRANS për 385.85 €. Operatori RAILTRANS për këtë periudhë ka revokuar të gjithë trenat e rregullt.

Kjo domosdoshmëri paraqet një lajm të keq për INFRAKOS-in kur dihet që të hyrat tona kryesore varen nga pagesat e qasjes në binarë të këtyre dy operatorëve për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, atëherë çdo rënie e të hyrave për ne paraqet një problem shtesë financiar.

2.1.4 Terminali i mallrave

Në këtë tremujor, ngjashëm me vitin e kaluar për fat të keq numri i kontejnerëve të transportuar në terminal ka qenë zero, gjë që ka ndikuar automatikisht në rënien e të hyrave të terminalit për shërbimet e ofruara. Tanimë, kjo situatë duhet seriozisht të analizohet nga operatorët e transportit TRANKOS dhe RAILTRANS.

Tabela 6 Të hyrat në terminalin e mallrave në K1 2022

Periudha kohore	Numri i kontejnerëve	Të hyrat nga krani	Të hyrat nga piruneri	Të hyrat nga fletëhyrjet	Totali i të hyrave
(Janar – Mars) 2022	0	0.00	40.00	40.00	80.00
(Janar – Mars) 2021	0	0.00	368.00	750.00	1 118.00
Diferenca (2022 - 2021)	0	0.00	-328.00	-790.00	- 138.00

2.2 Departamenti i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, ky departament është marrë me mirëmbajtjen e linjave hekurudhore dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse në mënyrë që qarkullimi i trenave dhe mjeteve tjera lëvizëse të bëhet pa problem dhe me sigurinë maksimale. Përkundër vështirësive të caktuara, realizimi i detyrave të këtij departamenti ka qenë në nivelin e kënaqshëm. Në mënyrë të veçantë është punuar edhe gjatë sezonit dimëror në pastrimin e borës dhe akullit në ndërruese, si dhe nëpër tunele ashtu që të mos rrezikohet qarkullimi i trenave.

Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore përkundër vështirësive financiare të kompanisë ka arritur që të ruaj koherencën për nivelin e lartë të mirëmbajtjes së infrastrukturës ekzistuese hekurudhore, përfshirë këtu binarët hekurudhor me tërë infrastrukturën e tyre përkatëse, urat, tunelet, lëshesat, kanalet ujë përcjellëse, platotë për ngarkim/shkarkimin e mallrave, vendkalimet në nivel, si dhe të gjitha objektet tjera për ofrimin e shërbimeve hekurudhore.

Gjatë kësaj periudhe është bërë kontrollimi i gjendjes së shtresës së ultë dhe shtresës së lartë në linjat hekurudhore me shikim vizual, matje dhe me mjete lëvizëse, meqë rast janë vërtetuar parametrat teknik të linjës, rregullsia e binarit, rregullsia e materialit të binarit dhe objekteve të shtresës së ultë. Të gjitha parregullsitë e konstatuara janë eliminuar me kohë. Përveç vëzhgimit të linjave që janë në operim janë vëzhguar edhe linjat hekurudhore jashtë operimit: Klinë - Xërxë – Prizren, Prishtinë – Podujevë dhe Mitrovicë – Kastriot.

Në vijim janë prezantuar detyrat kryesore të realizuara në këtë tremujor.

2.2.1 Rregullimi i gjeometrisë së binarit




Gjatë periudhës janar - mars 2022 është bërë kontrollimi i rregullt i hekurudhës dhe objekteve përcjellëse sipas planifikimit mujor dhe duke u bazuar në rregulloret ekzistuese. Kontrollimet janë kryer si kontrollime vizuale të hekurudhave dhe objekteve nëpër linjat hekurudhore duke ecur dhe duke evituar mangësitë e identifikuar në kohë sa më të shkurtë. Një punë e madhe është bërë edhe në përcjelljen e gjendjes së binarëve, kështu që pas evidentimit të mangësive eventuale është bërë intervenimi i menjëhershëm me makineritë dhe personelin e mirëmbajtjes për evitimin e të gjitha prishjeve duke e bërë rregullimin e binarëve sipas standardeve të kërkuara.

2.2.2 Rregullimi i gjeometrisë së binarit sipas kahut dhe niveletës me fuqi punëtore dhe makina plaser

Njëra nga punët kryesore gjatë mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka të bëjë me rregullimin e deformimeve të niveletës, kahut dhe planifikimi i koltrinės-balastit në linjat hekurudhore. Në mënyrë që të kemi linja të sigurta për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, gjatë këtij tremujori është bërë mirëmbajtja e rregullt e të gjitha linjave hekurudhore në funksion me makinën Plasser.



2.2.3 Mirëmbajtja dhe kontrollimi i ndërrueseve



Departamenti për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore ka bërë kontrollimin vizual të ndërrueseve tri herë në muaj dhe një herë me matje. Së bashku me Departamentin e veprimtarisë elektroteknike dhe Departamentin e Komunikacionit ka bërë kontrollimin teknik të ndërrueseve një herë në muaj. Tek linjat hekurudhore të cilat nuk kanë zhvillim të rregullt të komunikacionit, kontrollimet janë bërë sipas Rregullores 314.

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe mirëmbajtja e ndërrueseve. Në këtë pozicion të punëve bëhet rregullimi i deformimeve të niveletës, kahut, pjesëve të dëmtuara dhe planifikimi i koltrinës-balastit nëpër ndërruese të stacioneve hekurudhore. Kjo punë është kryer me mjaft sukses duke përdorur makinën Plasser e cila e mundëson një gjë të tillë, duke e zëvendësuar

punën fizike e cila më përpara është kryer nga punëtorët. Kjo mirëmbajtje ka garantuar një qarkullim të sigurt të trenave të udhëtarëve dhe mallrave.

2.2.4 Zëvendësimi i traversave të vjetërsuara



Njëra ndër punët më të rëndësishme në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore ndërlidhet me mirëmbajtjen e rregullt dhe evitimin e mangësive nëpër binarët hekurudhor, përfshirë këtu zëvendësimin e traversave të vjetërsuara të cilat e cenojnë sigurinë e komunikacionit hekurudhor. Gjatë këtij tremujori është bërë zëvendësimi i rregullt i traversave të vjetërsuara në linjë të hapur dhe binarë të stacionit hekurudhor ashtu që të garantohet siguria maksimale e qarkullimit të trenave.


2.2.5 Rregullimi i zonave të vendkalimeve në nivel

Duke parë se shumica e aksidenteve kanë ndodhur dhe ndodhin në vendkalimet në nivel të njëjtë hekurudhë – rrugë, atëherë njëra nga detyrat me prioritet të lartë gjatë këtij tremujori ka qenë e ndërlidhur me rregullimin e zonës së vendkalimeve në nivel të njëjtë. Kjo punë është kryer me sukses dhe të gjitha vendkalimet e rregulluara tani kanë një nivel të kënaqshëm gjë që mundëson një lëvizje më të lehtë të automjeteve rrugore. Në fotografitë vijuese është paraqit zona e vendkalimit pas dhe para rregullimit.




2.2.6 Pastrimi i akullit dhe borës në binarë, ndërruese dhe vendkalime

Duke marrë parasysh se sezoni dimëror gjithnjë paraqet një problem tejet të madh në zhvillimin e komunikacionit hekurudhor sepse bëhet mbulimi i ndërrueseve nga bora dhe akulli, gjë që pengon qarkullimin e trenave nga njëri binar në tjetrin, departamenti i linjave hekurudhore edhe këtë tremujor ka bërë një punë të shkëlqyer në pastrimin e ndërrueseve, vendkalimeve dhe një pjese të binarëve nga bora. Pastrimi i binarëve dhe ndërrueseve nga bora dhe akulli është treguar në fotografitë vijuese. Kjo ka mundësuar qarkullimin pa pengesë të trenave.



2.2.7 Pastrimi i akullit në tunele



Përveç pastrimit të borës në stacione, ndërruese dhe vendkalime, departamenti i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka bërë edhe pastrimin e rregullt të borës në linjat e hapura hekurudhore aty ku kjo ka qenë e domosdoshme, por vlen të ceket se vëmendje e posaçme i është kushtuar pastrimit të tuneleve ku për çdo dimër krijohen shtresa të mëdha të akullit të cilat e cenojnë sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

2.2.8 Pastrimi dhe rregullimi i lëshesave dhe kanaleve ujë përcjellëse





Departamenti i MLH-së ka bërë pastrimin e kanaleve anësore dhe lëshesave nëpër të gjitha linjat hekurudhore në mënyrë që gjatë reshjeve atmosferike të mos vjen deri te vërshimi i binarëve hekurudhor.

Gjatë këtij tremujori në veçanti është intervenuar në pastrimin e kanaleve dhe lëshesave për të cilat ekziston një rrezik potencial i përmytjeve.

2.2.9 Pastrimi i profilit të lirë

Në tremujorin e parë 2022 është bërë pastrimi i vazhdueshëm i profilit të lirë në të gjitha linjat hekurudhore ashtu që linjat hekurudhore të garantojnë sigurinë maksimale të qarkullimit të trenave. Departamenti i MLH-së e ka një përvojë të gjatë dhe ekspertizë të mjaftueshme për realizimin e mirëmbajtjeve të tilla dhe kjo bëhet sipas standardeve dhe rregulloreve në fuqi.

Gjithashtu, është bërë pastrimi i gurëve afër terreneve me pjerrësi të mëdha dhe në pjesët ku ka prerje të terrenit.



2.2.10 Lyerja dhe përpunimi i bulonave



Mirëmbajtja e pjesëve përforcuese të binarëve është punë e një rëndësie të veçantë pasi që me këtë sigurohet që binari të ketë parametrat e kërkuar për të garantuar sigurinë e qarkullimit të trenave. Prandaj njëra ndër punët e realizuara gjatë këtij tremujori ndërlidhet edhe me lyerjen dhe përforcimin e bulonave mbajtës të shinave në traversat e binarëve, punë kjo e cila bëhet në mënyrë të vazhdueshme.

2.2.11 Rrënimi i vendkalimeve ilegale

Një punë tepër e mirë është bërë edhe në rrënimin e vendkalimeve ilegale të cilat janë ndërtuar në linjat hekurudhore vite më parë pa leje. Vendimi i menaxhmentit ka qenë që të bëhet largimi i menjëhershëm i këtyre vendkalimeve, gjë që edhe është realizuar nga komisioni i veçantë i kompanisë në bashkëpunim me Departamentin e MLH-së.



2.2.12 Planifikimi i koltrinës



Planifikimi i prizmës i koltrinës është bërë në linjë të hapur dhe nëpër ndërruese. Planifikimi është bërë me makinën SSP 103 dhe me fuqi punëtore. Në periudhën Janar-Mars 2022 është punuar në të gjitha linjat hekurudhore.

2.2.14 Transporti i punonjësve dhe materialit të punës



Mirëmbajtja e binarëve hekurudhor ndërlidhet ngushtë edhe me materialin e punës dhe pjesët rezervë të zëvendësimit. Kështu që edhe këtë tremujor departamenti i MLH-së ka organizuar transportin e materialit të nevojshëm dhe punëtorëve në secilën pjesë të hekurudhës ku ka qenë nevoja të intervenohet për eliminimin e pengesave dhe zëvendësimin e pjesëve të ndryshme të binarëve, përfshirë edhe shinat hekurudhore.

2.3 Departamenti i veprimtarisë elektroteknike

Departamenti i Veprimtarisë Elektroteknike gjatë këtij tremujori i ka realizuar me sukses objektivat e parapara me Planin e Veprimit i cili ka dalë nga Plani i Biznesit 2022. Objektivi kryesor i këtij departamenti në tremujorin e parë të vitit 2022 ka qenë mirëmbajtja e pajisjeve SS, TK dhe EN ashtu që ato të kryejnë me sukses misionin për çka janë dedikuar. Në kuadër të këtij objektivi departamenti ka pasur aktivitet të përhershëm në evitim të shpejtë të pengesave duke intervenuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që të mos ketë probleme gjatë qarkullimit të trenave.

Objektivat e departamentit të VET në këtë tremujor kanë qenë:

- Ngritja e sigurisë së komunikacionit hekurudhor;
- Mirëmbajtja e rregullt dhe funksionale e pajisjeve SS, TK dhe EN;
- Përcjellja e Dizajn Projektit për Rehabilitim të hekurudhës;
- Realizimi i automatizimit të tetë vendkalimeve në linjën hekurudhore Fushë Kosovë-Pejë
- Shpenzimet buxhetore në Departament (Janar-Mars 2022).

Meqenëse pajisjet sinjalo siguroese, telekomunikuese dhe ato të energjetikës janë të shtrira në tërë rrjetin hekurudhor, është normale që këto pajisje të kenë probleme të ndryshme për shkak të ndikimeve të palëve të treta mbi këto pajisje. Gjatë këtij tremujori ka pasur pengesa dhe dëmtime të caktuara të stabilimenteve SS, TK dhe EN, mirëpo veprimi i shpejtë i ekipeve të mirëmbajtjes ka bërë që këto pengesa të eliminohen menjëherë, ashtu që të mos cenohet siguria e komunikacionit hekurudhor.

Gjatë këtij tremujori të tria shërbimet e këtij departamenti kanë realizuar me sukses detyrat e parapara, kështu që pajisjet sinjalo siguroese, të telekomunikacionit dhe ato të energjetikës edhe pse në kushte të vështira për shkak të mungesës së pjesëve rezervë të mjaftueshme, gjatë gjithë kohës kanë qenë në funksion të plotë.

Varësisht nga kërkesa e konsulentit për Dizajn ekipet e departamentit kanë punuar në identifikimin e faktorëve të rëndësishëm që Dizajni të jetë i kompletuar. Ekipet e shërbimeve SS,TK dhe EN sipas kërkesës së punë kryesit kanë asistuar në teren që të mos ketë dëmtime në rrjetin e kablove e sidomos në stacionet Miradi, Lipjan, Ferizaj, Gurëz dhe Han të Elezit.

Për shkak të punimeve ndërtimore në rehabilitim të vijës hekurudhore sistemet SS në stacionet Lipjan, Bablak, Ferizaj, Gurëz dhe Han të Elezit janë shkyçur. Brenda muajit prill pritet të shkyçet edhe stacioni i Kaçanikut. Tani janë jashtë funksionit pajisjet SS, dhe stacionet Lipjan, Bablak, Ferizaj, Gurëz dhe Hani i Elezit nuk janë të siguruara me sistem sinjalizimi. Gjithashtu jashtë funksionit janë edhe pajisjet e vendkalimeve të mbrojtura në zonën e stacionit që janë të ndërlidhura me rrugë udhëtime. Tani drejtuesi i trenave nuk ka kontroll në pultin komandues të sinjaleve, të ndërrueseve, të brezave izolues dhe vendkalimeve. Tani e tutje deri në instalim të sistemit të ri sinjalo-sigurues rregullimi lëvizjes së trenave në stacion bëhet ashtu si e parash rregullorja e komunikacionit kur sinjalet nuk punojnë.


Lloji i intervenimeve për eliminimin e pengesave dhe disa nga detyrat kryesore të realizuara në këtë periudhë kohore janë renditur në vijim:

- Kontrollimi mujor i ndërrueseve së bashku me departamentin e komunikacionit dhe MLH-së nëpër linjat hekurudhore në operim;
- Evitimi i pengesave në mekanizmat elektrik për vendosjen e ndërrueseve;
- Zëvendësimi dhe riparimi i pjesëve të dëmtuara të stabilimenteve kontrolluese;
- Rregullimi dhe riparimi i vendkalimeve automatike në nivel, sidomos pas thyerjes së gjysmë barrierave nga vozitësit e pakujdesshëm; Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe është instaluar komplet VK në Pejë (bazamenti i shtyllave të sinjaleve, mekanizmi elektrik për barriera, reflektorët e sinjaleve rrugore, testimi i komandave për mbyllje të VK-së, instalimi i kamerave, kabllot i furnizimit, etj.) i cili është paraqitur në fotografitë vijuese;
- Riparimi i vazhdueshëm i ormanëve metalik në të cilët janë të vendosura stabilimentet SS dhe kabllot e sinjalizimit;
- Intervenimi dhe riparimi i sinjaleve elektrike nëpër stacione, kurdo që për këtë ka pasur nevojë;
- Mirëmbajtja e pajisjeve të brendshme elektro-releike si dhe pajisjeve të furnizimit me tension duke bërë zëvendësimin e elementeve të prishura;
- Kontrollimi dhe intervenimi i rregullt në mirëmbajtjen e baterive stacionare për furnizim me energji të pajisjeve SS dhe TK;
- Zëvendësimi i menjëhershëm i kablove të vjedhura SS nga palët e treta dhe riparimi i stabilimenteve përkatëse;
- Riparimi i defekteve në antenat e sistemit të radiolidhjeve;
- Evitimi i vazhdueshëm i pengesave në sistemin e telefonisë nëpër zyra dhe stacionet hekurudhore;
- Mirëmbajtja dhe evitimi i pengesave në video sistemin e vrojtimit të stacioneve;
- Raportimi mbi shpenzimet për telefoni fikse;
- Eliminimi e pengesave në sistemin energjetik, përfshirë këtu, rrjetin e ndriçimit, instalimet elektrike, trafo stacionet, gjeneratorë, shtrirjen e kablove energjetike, e kështu me radhë;
- Matje të nevojshme të pajisjeve SS, TK dhe EN;
- Angazhimi në projektin e sigurimit të vendkalimeve automatike në linjën hekurudhore të Pejës, duke përfshirë këtu edhe angazhimin në projektin JASPERS;
- Testimi i kablove optike dhe evitimi i problemeve në to;
- Angazhimi në përpilimin e ToR për linjën Klinë-Prizren dhe për linjën Fushë Kosovë-Klinë-Pejë;
- Angazhimi në plotësimin e të dhënave për VK-të së bashku me UIC.



Si zakonisht edhe këtë tremujor departamenti ka pasur sfida të konsideruara, ku ndër problemet më të mëdha kanë qenë dëmtimet e kabllave të sinjalizimit dhe atyre optike të telekomunikimit si dhe ato të Telekomit të Kosovës, të cilat janë bërë nga kompania punëkryese GCF për Rehabilitimin dhe Modernizimin e Fazës së parë të Linjës së dhjetë Hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Këto dëmtime, përveç kostos të riparimit të cilën e bartë kompania punëkryese, kanë shkaktuar edhe dëme tjera në pamundësinë e operimit të pajisjeve sinjalo siguroese, dhe dëmeve të cilat ndërlidhen me Telekomin e Kosovës.

Për ilustrim më të mirë në vijim është bërë prezantimi me fotografi i dëmtimit të disa kabllave nga kompania punëkryese dhe rregullimi i tyre.



Një problem tjetër shtesë paraqet edhe ndërprerja e punës së pajisjeve sinjalo siguroese në stacionet ku kryhen punët e rehabilitimit, e në veçanti ndërprerja e punës së vendkalimeve automatike, kështu që deri në montimin e pajisjeve të reja sinjalo siguroese të cilat duhet të instalohen me projektin e modernizimit, ne do të kemi probleme sa i përket mos funksionimit të pajisjeve SS. Pajisjet e shkyçura sinjalo-siguroese, sinjalet në stacione, dhe vendkalimet në Han të Elezit janë treguar në fotografitë në vijim.



Sfida të tjera me të cilat Departamenti i veprimtarisë elektroteknike vazhdimisht përballet janë vjedhjet e vazhdueshme të kablove apo pajisjeve tjera sinjalo siguroese si dhe mungesa e pjesëve rezervë. Kushtet e vështira atmosferike (shiu, bora, temperaturat e ulëta) kanë ndikuar në shtyrjen e punëve.

2.4 Zyra e planifikimit dhe zhvillimit

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim gjatë periudhës tremujore (janar – mars) 2022 ka vazhduar punën për të siguruar ngritjen e performancës së zyrës në funksion të shërbimit të interesave të kompanisë, si një synim i vazhdueshëm dhe me qëllim të plotësimit të kriterëve dhe nevojave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

Ky raport reflekton mbi aktivitetin e stafit të zyrës për Planifikim dhe Zhvillim përfshirë zhvillimet më të rëndësishme e veçmas ato në periudhën tremujore, ku është vazhduar me punët në zbatimin e planin vjetor të punës së zyrës dhe njëkohësisht është bërë përcjellja e punëve të cilat janë të ndërlidhura me këtë zyre.

Objektivat e zyrës edhe gjatë kësaj periudhe kanë qenë:

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit të infrastrukturës hekurudhore;
- Ngritja e bashkëpunimit brenda kompanisë, me institucione vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe modernizimit të linjave hekurudhore;
- Hulumtimi i zhvillimeve, të arriturave në teknologjinë e sistemeve hekurudhore dhe propozimet e mundshme për zbatimin e tyre;
- Përpilimi i analizave financiare duke u mbështetur në kornizat buxhetore dhe projekte.

Aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura janë paraqitur në vijim:

- Ofrimi dhe mbështetja profesionale në realizimin e kërkesave të ndryshme në nivel të kompanisë dhe detyrave të dala nga mbledhjet e menaxhmentit;
- Angazhimi në përcaktimin e projekteve kapitale për vitin 2022 sipas limitit të përcaktuar me buxhetin e Republikës së Kosovës;
- Hartimi i koncept dokumentit për vendosjen e sistemit GPS, në gjitha automjetet e INFRAKOS-it;
- Vendosja e kontakteve për mundësinë e bashkëpunimit me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për mbështetje profesionale në hartimin e digjitalizimit të pronës së INFRAKOS;
- Hartimi i koncept dokumentit për evidentimin e vajtje ardhjeve në punë të punonjësve të INFRAKOS-it;
- Përcjellja e objektivave pothuajse e të gjitha strategjive nacionale, regjionale dhe të Ballkanit Perëndimor të cilat kanë të bëjnë me transport dhe infrastrukturë;

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim përveç punëve dhe detyrave të përshkruara më lartë, ka vazhduar të kryej edhe punët që janë paraparë në planin e veprimit të kësaj zyre për tremujorin e parë të këtij viti si dhe është angazhuar në punë tjera të nevojshme për nevojat e INFRAKOS-it.

Përkundër sfidave të caktuara, ne mund të konstatojmë se performanca e Zyrës për Planifikim dhe Zhvillim gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka qenë në nivelin e duhur dhe se kjo zyre do të vazhdon t'i realizoj me sukses detyrat e parapara edhe në tremujorin vijues.

2.5 Departamenti i administratës

Departamenti Administratës së Përgjithshme ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar edhe gjatë këtij tremujori të vitit 2022 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij departamenti dhe kompanisë në tërësi. Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe këtë ia ka arritur me mjaft sukses.

2.5.1 Sektori i Personelit

Ka pasur angazhim të vazhdueshëm në administrimin e personelit dhe detyrave tjera, me synim arritjen e objektivave, uljen e moshës mesatare dhe përmirësimin e strukturës gjinore. Detyrat e realizuara të këtij sektori në mënyrë të detajuar janë paraqitur në tekstin vijues.

Ky sektor në mënyrë aktive ka punuar dhe punon në menaxhimin e burimeve njerëzore duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e parapara me planin e biznesit, respektivisht me planin e veprimit të kompanisë.

Objektivat sipas planit të biznesit për të cilat ka pasur angazhim maksimal për realizimin e tyre janë prezantuar në vijim:

- Menaxhimi i rregullt i burimeve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi);
- Pagat dhe kompensimet tjera të punëtorëve;
- Disiplina në punë;
- Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara;
- Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Infrakos SH.A. në fillim të muajit janar 2022 ka startuar me 264 punëtorë të rregullt të rregullt dhe pa anëtarë të bordit, kurse në të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar Infrakos SH.A. ka filluar muajin janar 2021 me 281 punëtorë të rregullt dhe 4 anëtar të bordit.

Struktura e të punësuarve më 01/01/2022 varësisht nga kategoritë është si vijon:

- Punonjës me marrëdhënie të rregullt të punës janë 264 prej të cilëve 209 ose 79,16 % kanë kontrata pune në afat të pa caktuar, 40 ose 15,15 % kanë kontrata pune në afat të caktuar, 13 ose 4,92 % janë të sistemuar me vendime.
- Moshë mesatare e të punësuarve në Infracos SH.A është rreth 50 vjeç;
- Meshkuj janë 246 të punësuar dhe përbëjnë 93,24% nga totali i të punësuarve;
- Femra janë 16 të punësuar dhe përbëjnë 6,37% nga totali i të punësuarve;
- Shqiptarë janë 257 të punësuar dhe përbëjnë 90,75% nga totali i të punësuarve;
- Serb janë 6 të punësuar dhe përbëjnë 2,14% nga totali i të punësuarve;
- Ashkalinjë dhe rom janë 1 të punësuar dhe përbëjnë 0,36% nga totali i të punësuarve;
- Me shkollë fillore ose të kualifikuar nga Hekurudhat kemi gjithsejtë 34 punëtorë;
- Me shkollë të mesme kemi gjithsejtë 154 punonjës;
- Me shkollë të lartë kemi gjithsejtë 6 punëtorë dhe
- Me shkollim superior kemi gjithsejtë 70 punëtorë.

Në fund të majit Mars INFRAKOS SH.A ka pasur 262 punëtorë të rregullt dhe ju kanë shtuar edhe 6 anëtarë të Bordit, duke arritur gjithsej 268 të punësuar.

Menaxhimi i rregullt i Burimeve Njerëzore (punësimi, largimi, transferimi, pensionimi, etj.)

- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar të gjitha detyrat të ndërlidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore. Sektori i BNJ ka bërë rregullisht evidentimin dhe menaxhimin e çështjeve më të rëndësishme të cilat ndërlidhen me punësimet, kontratat, konkurset, ndërprerjet e punës, organizimin e punës për praktikantë, evidentimin dhe përgatitjen e listave të pagave.

BNJ kanë përgatitur regjistrat e punëtorëve aktiv, punëtorëve të cilët pensionohen gjatë vitit 2022, përvojës së punës, pushimeve vjetore, mjekësore dhe statusore, dhe shumë të dhëna tjera si bazë e punës vjetore.

Punësimi - Gjatë tremujorit të parë 2022 INFRAKOS-i nuk ka pasur asnjë punësim të ri.

Transferimi - Gjatë këtij tremujori është bërë një transferim, ku pozita Asistente e patundshmërisë është caktuar në pozitën U.D. Zyrtare e Patundshmërisë.

Ndërprerje e marrëdhënies së punës - Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur pensionime, ndërsa një punëtor ka vdekur.

Pushim pa pagesë - Gjatë kësaj periudhe janë lejuar pushime pa pagesë për dy punëtorë:

- Asistent në Patundshmëri i lejohet pushimi pa pagesës për 6 muaj;
- Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim i lejohet pushimi pa pagesë edhe për 3 muaj shtesë.

Stafi pa kontrata - Vendimi është ende në fuqi për kontratat e punës gjithashtu edhe pozitat që janë me U.D. të vendimeve të përkohshme do të vazhdojnë punën deri në një vendim tjetër të KE-së. Ky vazhdim i vendimit do të vlejë deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Rregullores mbi Sistematizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në Infracos.

Pagat dhe kompensimet tjera për punëtorët - Sa i përket dokumentacionit (evidenca e orëve të punës, puna e natës, puna jashtë orarit, puna në fundjavë, puna në festë, pushimi vjetor, pushimi mjekësor, pushimi statusor, etj.) të dërguar nga Burimet njerëzore për t'u proceduar te llogaritja e pagave secili dokument është i bazuar në ligj dhe në aktet tjera normative të cilat janë në fuqi.

Disiplina në punë - Gjatë periudhës tre mujore ka pasur dy masa disiplinore:

- Drejtuesit të trenave në stacionin Fushë Kosovë i shqiptohet masa disiplinore zbritje nga të ardhurat personale për tre muaj në 5%;

- Ndërruesit të binarit në stacionin e Fushë Kosovës i shqiptohet masa disiplinore zbritje nga të ardhurat personale për tre muaj në 7%.

Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara - Burimet njerëzore edhe gjatë këtij tremujori kanë kryer në vazhdimësi punë rreth pajisjes së punëtorëve, ish punëtorëve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe palëve të treta me dokumentacion për nevojat e tyre personale.

Përcjellja e pushimeve vjetore, mjekësore dhe pushimeve tjera statusore - Për periudhën tre mujore janar - mars, resurset njerëzore janë marrë edhe me menaxhimin e pushimeve vjetore të punëtorëve. Resurset njerëzore kanë bërë në mënyrë të rregullt zbatimin e kërkesave të punonjësve për pushim vjetor. Nga punëtorët kërkohet të respektohen afatet ligjore për shfrytëzimin e pushimeve vjetore.

2.5.2 Shkrimorja dhe arkivi

Në protokollin e punës të shkrimores së INFRAKOS-it brenda kësaj periudhe kanë qarkulluar këto lëndë të natyrave të ndryshme: 73 kërkesa hyrëse, 74 lëndë nga gjykata, 205 fatura hyrëse, 98 lëndë të punuara brenda dhe shpërndara jashtë, 37 lëndë të punuara brenda dhe shpërndara brenda, 27 dërgesa me postë dhe 120 kontrata për dhënien e pronës me qira.

Me datë 05.01.2022 janë dhënë dy numra rendorë (8 dhe 9) nga protokollin i brendshëm i arkivit për PIU –në për regjistrimin e të gjitha shkresave që kanë të bëjnë me Rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 për fazën e tretë.

2.5.3 Shërbimi i logjistikës

Shërbimi i Logjistikës ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar gjatë këtij tremujori në përpjekje për të përbushur objektivat e këtij shërbimi. Secila njësi dhe komplet shërbimi ka punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara, me gjithë vështirësitë që jemi ballafaquar në këtë periudhë për shkak të gjendjes dhe vjetërsisë së veturave. Përkundër kësaj, mirëmbajtja e veturave gjatë kësaj periudhe ka përbushur me sukses objektivat, ku është kryer servisimi i rregullt i të gjitha veturave, riparimi i 3 automjeteve, regjistrimi dhe sigurimi në afatet e parapara, kompletimi me të gjitha pajisjet përcjellëse, pastrimi dhe furnizimi i rregullt me naftë, përcjellja e fletudhëtimeve dhe kilometrave të kaluara për çdo veturë veç e veç dhe për të gjitha së bashku.

Pastrimi në përgjithësi ka arritur objektivat e veta ku me sukses ka arritur që të bëjë pastrimin e të gjitha hapësirave të objekteve dhe zyrave dhe ambientit të jashtëm.

Sfidë tjetër mbetet menaxhimi i lëvizjes së automjeteve nga sektorët të cilët jo gjithëherë i përdorin veturat në mënyrë racionale.

2.5.4 Shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve

Kryesisht janë bërë punë të rregullta rreth nxehjes qendrore, ndezjes dhe pastrimit të kaldajave, zhvendosjen dhe pastrimin e radiatorëve me rrjetin përcjellës. Gjatë periudhës tremujore për nxehjen qendrore janë shpenzuar 170260 kg thëngjill.

Është bërë mirëmbajtja e vazhdueshme e të gjitha objekteve dhe inventarit brenda zyrave sipas kërkesave ditore dhe planeve të veprimit.

Gjithashtu janë bërë intervenime dhe riparime të ndryshme në tërë rrjetin hekurudhor sipas nevojave dhe kërkesave të shërbimeve të ndryshme të kompanisë.

2.6 Departamenti i MP, SHMP & IT

Departamenti i Marrëdhënies me Publikun, Shkollim Mbrojtje në Punë dhe Teknologji Informative është departamenti i cili tashmë është krijuar mbi bazën e strukturës organizative në kompaninë INFRAKOS i cili departament përmban në vete tre sektorë përkatës dhe një zyre të marketingut si më poshtë:

- Sektori për Marrëdhënie me Publikun;
- Sektori për Shkollim, Siguri dhe Mbrojtje në Punë;
- Sektori për Teknologji Informative, dhe
- Zyra për Marketing.

Ky departament është duke i zhvilluar aktivitetet e veta në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij departamenti dhe kompanisë në tërësi.

2.6.1 Sektori për marrëdhënie me publikun dhe marketing

Gjatë kësaj periudhe sektori ka përmbushur me sukses objektivat e tij në bazë të Planit të punës e përcaktuar me Planin e Biznesit duke ndërtuar strategji të pasqyrimin të mediave gjë që ka arritur me sukses përmbushjen e objektivave të INFRAKOS-it. Sektori mban kontakte të vazhdueshme dhe përcjell mediat elektronike në vazhdimësi.

Po ashtu kjo zyre kujdeset për nevojat e përkthimeve të vazhdueshme në kompani duke i kryer të gjitha obligimet në bazë të kapaciteteve që kemi, si dhe në mënyrë permanente bënë dhe përcjell çështjet e marketingut.

2.6.2 Sektori për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë

Ky sektor ka përmbushur me rregull planifikimet, ka bërë administrimin dhe planifikimin e shkollimit. Sa i përket sigurisë në punë kemi një situatë të mirë, natyrisht jemi në përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të punës të stafit.

Vlen të përmendet se ky sektor është zhvilluar edhe më tej me ngritjet e kapaciteteve të brendshme të ciklit të parë dhe të dytë për shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen në punë e financuar nga BERZH-i e që ka zgjatur plot 17 muaj, ndërsa cikli i dytë ka përfunduar dhe është bërë auditimi teknik gjë që kemi përfituar me certifikimin e sistemit të menaxhimit të shëndetit, sigurisë dhe mbrojtjes në punë po ashtu edhe ky cikël i financuar nga BERZH-i.

2.6.3 Sektori i teknologjisë informative

Sektori i TI-së i ka arritur objektivat e veta duke u angazhuar në ngritjen profesionale të stafit, në mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve, në ngritjen e nivelit të sigurisë së sistemit, në ngritjen e nivelit të sistemit të komunikimit në E-mail sistem, në ngritjen e efikasitetit në realizimin e projekteve të, në furnizimin me material për mirëmbajtje efikase të sistemit dhe rrjetës së Teknologjisë Informative.

Si në çdo sektor tjetër edhe në sektorin e teknologjisë informative është bërë punë e zellshme në kryerjen e detyrave dhe obligimeve që rrjedhin nga plani i biznesit për vitin 2022. Në veçanti janë realizuar këto detyra:

- Mirëmbajtje e rregullt efektive e pajisjeve dhe rrjetës së Teknologjisë Informative;
- Ngritja e nivelit të sigurisë së sistemit të Teknologjisë Informative;
- Janë montuar, instaluar dhe konfiguruar pajisje kompjuterike sipas nevojës dhe kërkesave të zyrtarëve të Infracos-it;
- Instalimi i antivirusit;
- Ngritja e Sistemit Operativ të PC-ve nga Windows 7 në Windows 10;

- Monitorimi i serverëve;
- Përgatitja e specifikimeve të furnizimit me pajisje (material) të Teknologjisë Informative me buxhet të konsoliduar të Kosovës për vitin 2022;

Sfidat në këtë sektor kanë qenë:

- Mirëmbajtja dhe funksionimi normal i rrjetës së internetit për shkak të instalimit të vjetruar të kabllove të rrjetit;
- Mos furnizimi me kohë me material;
- Ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike;
- Problemet me DHCP serverin për shpërndarjen e IP-ve dinamike në kompjuter;
- Problemet në wireless dhe kyçjet ilegale.

Për shkak të mungesës së investimeve në blerje në 6 vitet e fundit gjendja në sistemin TI-së nuk është e mirë (pajisjet janë vjetruar dhe pothuajse çdo ditë shumë pajisje dalin nga funksioni sidomos kompjuterët, printerët dhe UPS-ët). Mbi 25% e kompjuterëve të vjetër janë me Sistem Operativ Windows 7 dhe nuk përkrahin sistemin Operativ Windows 10.

2.7 Departamenti për pronë dhe standarde

Departamenti i Pronës dhe Standardeve, ka punuar në vazhdimësi për menaxhimin e suksesshëm të pronës. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhënat kryesore të tremujorit (janar – Mars) 2022.

Përmbajtja	Obiliq	Vushtrri	Mitrovicë	Bardh	Drenas	Klinë	Pejë	Xërxë- Krushë	Prizren	Fushë Kosovë	Hani Elezit	Kaçanik	Ferizaj	Lypjan	Prishtine	Podujeve	Miradi	Prelluzh	Gjithsej
Kontratat Vazhduese Lokale + Banesa	7	1	39	6	7	7	46	9	19	30	5	17	17	8	16	7	5	7	259
kontratat e reja						3	2		3			2							10
kontratat ne procedurë	2		4		3	2				5	1		3	1	2			9	16
Shkresa K.K					1	2	1		3	21					2				30
Kërkesa	2		3		3	2	11		8	9	1	1	5	1	9				55
Kërkesa të aprovuara nga prona janë:	1					1	1			4		1	1		2				11
Kërkesa në procedurë janë:			3		2		5		4	1	1		3	1	3				23
Pëlqime nga komisioni profesional janë:						1				1					3				5
Tërheqje nga pala është:									1										1
Refuzime nga komisioni prof. dhe nga prona janë:	1						4		2	3			2		2				14

Vlen të përmendet se:

Numri i kontratave për vitin 2021/22 deri me 01.04.2022 është ,259, prej të cilave 179 për lokalë, ndërsa 80 për banesa.

Sa i përket Sektorit për standarde dhe siguri gjatë kësaj periudhe kohore ka zhvilluar kontakte me ARH-në për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre duke raportuar për numrin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, numrin e personave të vdekur dhe të lënduar si dhe dëmet materiale për vitin 2021 dhe këtë tremujor.

Është punuar në mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve dhe raporteve të ngjarjeve të jashtëzakonshme, me qëllim të përgatitjes së raportit vjetor të sigurisë për vitin 2021. Në mënyrë kontinuale është punuar edhe në rregulloret e hartuara nga ARH-ja e të cilat ndërlidhen me fushë veprimtarinë e INFRAKOS-it.

2.8 Departamenti i prokurimit

Departamenti i Prokurimit gjatë tremujorit të parë të këtij viti i ka kushtuar kujdes të veçantë zbatimit të procedurave të furnizimit të kompanisë, duke garantuar kështu stabilitetin financiar, por edhe duke i plotësuar nevojat e kompanisë për punë të rregullt. Në bazë të planifikimit të prokurimit i cili është marrë nga projektet e aprovuara në buxhet, Departamenti i Prokurimit ka iniciuar procedurat sipas kohës së planifikuar për tenderim të projekteve dhe zbatimin e tyre. Prandaj, gjatë kësaj periudhe kohore departamenti i prokurimit është marrë me dy lloje të projekteve:

- Projektet kapitale të realizuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
- Projektet e furnizimit të realizuara nga Buxheti INFRAKOS-it.

2.8.1 Projektet kapitale nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Sipas të dhënave të cilat i menaxhon Departamenti i Prokurimit, nga mjetet e Buxhetit të Kosovës akoma nuk janë zhvilluar aktivitetet e përgatitjes së dokumenteve përkatëse lidhur me publikimin e projekteve kapitale të cilat priten të realizohen sipas planifikimit paraprak të përcaktuar me Planin e Biznesit 2022. Arsyeja qëndron në mos nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit, monitorimit dhe kontrollit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe INFRAKOS-it.

2.8.2 Projektet e furnizimit nga Buxheti i INFRAKOS-it

Varësisht nga kërkesat e njëjësive kërkuese dhe duke u bazuar në procedurat e prokurimit, gjatë kësaj periudhe kohore është realizuar me sukses furnizimi i të gjitha pjesëve rezervë dhe materialit tjetër të kërkuar nga të gjithë sektorët e INFRAKOS-it.

Departamenti i Prokurimit pas pranimit të kërkesave të aprovuara, ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka nënshkruar kontratat për furnizim për 11 projekte të ndryshme. Vlera e planifikuar e këtyre projekteve ka qenë 5,335.00 €, ndërsa vlera e kontraktuar është 5,290.13 €. Një projekt me vlerë të parashikuar 6,000.00 € është ende në procedurë.

Vlen të përmendet se të gjitha projektet e realizuara për këtë periudhë kohore janë kryer në tërësi duke iu përmbajtur rregullave dhe procedurave ekzistuese të prokurimit.

2.9 Kontrollori i brendshëm

Ky raport përfshinë aktivitetet tremujore të kontrollimit e të gjithë sektorëve ekzekutiv të kategorizuar në tri grupe:

- Kontrolli në stacione;
- Kontrolli në linjat hekurudhore, gjendja tyre;
- Kontrolli i stafit ekzekutiv.

Aktivitetet në TM1 2022 janë përmbledhur si në vijim:

- Përcjellja e trenave është bërë sipas planit të kontrollit dhe për vërejtjet e konstatuara janë hartuar raportet e nevojshme dhe janë dërguar në baza javore me kohë;
- Kontrollime, analiza në stacione, duke raportuar në formë ditore, javore dhe mujore për gjendjen në stacione dhe të shërbimeve në hekurudhat e Kosovës;
- Shkollimi i rregullt në Sektorin për Rregullimin e Komunikacionit është mbajtur nga shefat e stacioneve sipas plan programit për vitin 2022;
- Kontrollimi i teknik i ndërrueseve në tërë linjën hekurudhore është kryer në bashkëpunim me Departamentin e MLH-ës, Sektorin e Komunikacionit dhe Shërbimin e SS-it;
- Kontrollimi i vijës hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë;
- Kontrollimi i pajisjeve sinjalo-siguroese, shenjave treguese dhe kanaleve anësore për kullimin e ujit nga të reshurat atmosferike;
- Kontroll në stacionet Miradi, Lipjan, Bablak, Gurëz, Kaçanik, H. Elezit, Bardh, Drenas, Klinë, Pejë, Kastriot, Vushtrri, Mitrovicë;
- Kontrollimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani Elezit. Punimet në linjën hekurudhore Fushë Kosovë-Hani i Elezit janë prezantuar përmes fotografive në vijim.



Sa i përket organizimit të lëvizjeve të trenave të mallrave, operatori i transportit Railtrans vazhdon revokimin e trenave dhe në këtë periudhë ka operuar vetëm operatori Trainkos.

Në relacionin F. Kosovë-Drenas vazhdon faza testuese e katër vendkalime të mbrojtura me barriera automatike deri tek pranimi i tyre dhe licencimi nga organet kompetente, ndërsa vendkalimi në kilometrin 19+453 gjendet në prishje për shkak të dëmtimit nga pala e tretë.

Në linjën Fushë Kosovë-Hani i Elezit kanë vazhduar punimet për rehabilitimin e Linjës 10, ku kryesisht është duke u punuar në stacionin hekurudhor Fushë Kosovë në rehabilitimin e binarëve 1,2,3,4, Lipjan, Gurëz, Kaçanik, dhe Han të Elezit. Gjatë muajit shkurt në relacionin Lipjan – Hani Elezit në bazë të kërkesës së punë kryesit nga data 03.03.2022 deri me datë 23.04.2022, ka

pasur mbyllje 24 orëshe të linjës për nevojat e projektit, ku në këtë interval janë revokuar trenat e rregullt.

Gjatë TM1 2022 ka pasur dy raste të jashtëzakonshme, fatmirësisht nuk ka pasur fatalitet në njerëz. Të dy rastet kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë dhe mos respektimit të shenjave nga ana e drejtuesve të automjeteve rrugore, për çka nuk mbanë përgjegjësi INFRAKOS-i.

Vlen të ceket se përkundër problemeve të caktuara, departamentet ekzekutive i kanë kryer me sukses detyrat e parapara me planet e veprimit për tremujorin e parë të vitit 2022.

Performanca financiare e INFRAKOS-it



3. 1 Performanca financiare e INFRAKOS-it

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A, përkundër një numri të konsideruar të vështirësive ka pasur një angazhim maksimal drejt realizimit të detyrave të parapara në drejtim të ruajtjes së funksionimit të kompanisë duke pasur parasysh gjendjen jo të mirë financiare e cila na ka përcjellë edhe në këtë periudhë kohore.

Për fat të keq në këtë tremujor nuk është bërë as subvencionimi i pritur kështu që kjo e ka vështirësuar tej mase situatën edhe ashtu të vështirë financiare. Për sqarim më të mirë, në

tabelën vijuese është bërë prezantimi i të hyrave dhe shpenzimeve për këta tre muaj, duke e bërë krahasimin me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak.

Tabela 7 Të hyrat dhe shpenzimet në TM1 2022

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve për TM1 2022		Realizimi 2021	Realizimi 2022	Buxheti 2022	Diferenca	Diferenca
		A	B	C	B - A	B - C
TË HYRAT	Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit	113,273.42	42,813.01	83,750.00	-70,460.41	-40,936.99
	Të hyrat nga qiraja	148,543.22	194,931.78	177,500.67	46,388.56	17,431.11
	Të hyrat tjera	22,377.91	29,225.63	27,000.00	6,847.72	2,225.63
	Subvencionimi i diferencës së rrjetit	0.00	0.00	224,937.51	0.00	-224,937.51
	Të hyrat e shtyra	233,874.96	220,094.94	225,000.00	-13,780.02	-4,905.06
	Të hyrat totale	518,069.51	487,065.36	738,188.18	-31,004.15	-251,122.82
SHPENZIMET	Pajisjet	4,320.82	80.51	7,720.00	-4,240.31	-7,639.49
	Harxh. e lokal. ndërtesave	6,336.64	12,834.82	26,665.00	6,498.18	-13,830.18
	Energjia elektrike	31,190.58	28,009.35	39,000.00	-3,181.23	-10,990.65
	Nafta	3,653.00	4,958.08	12,450.00	1,305.08	-7,491.92
	Vajrat, lysterit, etj.	0.00	16.5	1,300.00	16.50	-1,283.50
	Materiali harxhues operativ	4,911.31	2,857.54	9,620.00	-2,053.77	-6,762.46
	Riparimet	2,631.03	2,356.11	22,430.00	-274.92	-20,073.89
	Shërbimet operative	0.00	30,511.37	8,730.00	30,511.37	21,781.37
	Udhëtimet zyrtare	0.00	249	1,128.00	249.00	-879.00
	Marketingu dhe publikimet	647.82	294	504.00	-353.82	-210.00
	Mat. i zyrës dhe konsumues	608.84	505.76	1,660.24	-103.08	-1,154.48
	Telefoni / mail / interneti	2,449.52	1,881.99	4,550.00	-567.53	-2,668.01
	Shpenzimet e rrezikshmërisë	2,278.25	1,683.40	2,550.00	-594.85	-866.60
	Reprezentacioni / konsumueset	298.89	2,118.50	3,376.00	1,819.61	-1,257.50
	Sigurimi	2,052.48	1,937.24	6,650.03	-115.24	-4,712.79
	Stafi i jashtëm	0.00	0.00	1,060.00	0.00	-1,060.00
	Stafi dhe punëtorët	486,101.56	447,646.54	602,558.13	-38,455.02	-154,911.59
	Shpenzimet tjera operative	677.52	555	6,400.00	-122.52	-5,845.00
	Gjithsejtë shpenzimet	548,158.26	538,495.71	758,351.40	-9,662.55	-219,855.69
Diferenca (të hyrat – shpenzimet)		-30,088.75	-51,430.35	-20,163.22	-21,341.60	-31,267.13

3.2 Të hyrat

Të hyrat e INFRAKOS-it për TM1 2022 janë prezantuar në tabelën e mësipërme dhe si zakonisht këto të hyra përbëhen nga të hyrat e pagesave të qasjes në binarë (shfrytëzimi i rrjetit), të hyrat nga patundshmëria, të hyrat tjera dhe të hyrat nga subvencionimi. Në vijim është bërë përshkrimi i të hyrave të realizuara për secilin segment duke e bërë krahasimin e tyre me buxhetin e planifikuar dhe vitin paraprak.

3.2.1 Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit

Në muajt (janar – mars) 2022 janë realizuar 42,813.01 €, apo 40,936.99 € më pak sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 83,750.00 €. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kur këto të hyra ishin 113,273.42 €, del se janë realizuar 70,460.41€ më pak.

3.2.2 Të hyrat nga qiraja

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 194,931.78 € e që krahasuar me buxhetin 177,500.67 €, del se ne kemi realizuar 17,431.11 € më shumë të hyra se sa ka qenë e planifikuar për këtë periudhë, ndërsa krahasuar me vitin e kaluar 148,543.22 €, del se kemi realizuar 46,388.56 € më shumë të hyra.

3.2.3 Të hyrat tjera

Për këtë periudhë janë realizuar 29,225.63 €, ndërsa të planifikuara kanë qenë 27,000.00 €. Pra kemi realizim prej 2,225.63 € më të madh nga planifikimi, ndërsa krahasuar me vitin 2021 ku kishim të hyra në vlerën prej 22,377.91 €, për këtë periudhë kohore kemi 6,847.72 € më shumë të hyra.

3.2.4 Subvencionimi

Për tremujorin e parë subvencionimi i planifikuar për diferencës në mes të pagesave nga qasja në rrjet dhe kostos direkte të mirëmbajtjes prej 224,937.51 €, nuk është realizuar, andaj pritjet që ky subvencion të realizohet në muajt vijues.

3.3 Shpenzimet

3.3.1 Shpenzimet e planifikuara dhe realizuara

Sa i përket shpenzimeve mund të konstatojmë se shpenzimet e realizuara në këtë periudhë janë 538,495.71 € që në krahasim me shpenzimet e planifikuara 758,351.40 €, janë për 219,855.69€ më të vogla. Nëse këto shpenzime i krahasojmë me vitin 2021, vlera e të cilave ishte 548,158.26 €, atëherë del se në krahasim me vitin paraprak ne kemi shpenzuar 9,662.55 € më pakë se në të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Nga tabela e mësipërme shihet se shumica e shpenzimeve kanë qenë më të vogla sesa shpenzimet e planifikuara. Të vetmet tejkalime të shpenzimeve janë bërë tek shërbimet operative.

3.4 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Bazuar në tabelën e mësipërme e të hyrave dhe shpenzimeve shihet se diferenca në mes të hyrave të realizuara 487,065.36 € dhe shpenzimeve të realizuara 538,495.71 € është për 51,430.35 € më e madhe sesa të hyrat e realizuara.

3.5 Transaksionet financiare

Për periudhën (janar – mars) 2022, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS nuk ka pasur ndonjë transaksion të madh të mjeteve i cili vlen të përmendët. Pra, gjatë këtyre tre muajve janë bërë vetëm pagesat për shpenzimet operative, si dhe pagesat për furnizime të cilat nuk kanë pasur ndonjë vlerë të madhe e cila do të vlente të përmendët. Çka është më me rëndësi, të gjitha transaksionet janë bërë sipas ligjeve dhe rregulloreve tjera në fuqi për menaxhimin e financave.

Procedurat gjyqësore



5.1 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it

Zyra Ligjore e INFRAKOS-it gjatë periudhës tremujore (Janar – Mars) 2022 ka zhvilluar një punë të pandërprerë dhe profesionale në përfaqësimin e kompanisë pranë organeve kompetente si dhe janë ofruar këshilla ligjore, opinione dhe asistuar në punët e rregullta të kompanisë. Përkundër shumë sfidave është bërë një punë adekuate për përfaqësim profesional në gjykata dhe procedura përbarimore.

Në fund të tremujorit të parë si dhe pas shqyrtimit analitik të lëndëve, kemi konstatuar se në Zyrën Ligjore kemi 380 lëndë aktive në procedura ligjore, gjatë kësaj periudhe kanë arrit 4 lëndë të reja (nga të cilat në 3 raste jemi të paditur dhe 1 paditës), ndërsa kanë përfunduar 14 raste (nga të cilat në 12 raste jemi paditës dhe në 2 raste të paditur). Nga rastet e përfunduara, 10 raste janë në favor të Infrakos-it, ndërsa 4 raste janë në disfavor të Infrakos-it.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 53 seanca gjyqësore dhe është punuar në përgatitjen e lëndëve dhe parashtresave të ndryshme ligjore. Nga gjykatat kanë arritur 13 vendime gjyqësore, nga të cilat 6 janë në favor të Infrakos-it, 5 janë në disfavor të Infrakos-it, 1 pjesërisht në favor të Infrakos-it, për 1 rast kemi arritur marrëveshje gjyqësore, si dhe është tërhequr një padi pasi që pala e paditur ka përbushur në tërësi borxhin prej 4782.54€. Nga rastet gjyqësore dhe përbarimore janë inkasuar 11,112.03€, janë iniciuar 6 raste përbarimore nga lëndët gjyqësore në vlerë prej 7112.46€, ndërsa i janë tërhequr Infrakos-it 793€. Po ashtu gjatë TM1 kanë arritur 2 propozime për përbarim kundër Infrakos-it në vlerë prej 3977€. Gjatë kësaj periudhe po ashtu janë mbajtur kontaktet me përbaruesit privat të angazhuar më lëndët e Infrakos-it dhe në vazhdimësi kërkohet angazhim me i madh në drejtim të ekzekutimit të rasteve. Ngecjet janë kryesisht për shkak të mungesës së të dhënave pasi që kemi të bëjmë me lëndë të vjetra.

Stafi i zyrës ligjore ka një angazhim të vazhdueshëm në azhurnimin e bazës së të dhënave për lëndët në gjykata dhe procedurat përbarimore në mënyrë që menaxhmenti i kompanisë të mund të ketë një pasqyrë të qartë të vlerësimit të rrezikut dhe trendëve nga procedurat ligjore.

Mbetet sfida numri i madh i lëndëve, mundësia që ky numër të rritet për shkak të borxheve të mëhershme nga qiratë, mosnjohjes së dispozitave ligjore hekurudhore për distancat përgjatë brezit hekurudhor nga palët e jashtme, si dhe nga vet shtrirja e pronës në tërë territorin e vendit apo relacione tjera administrative, kontraktuale dhe jo vetëm. Është nevojë dhe kërkesë e zyrës ligjore që kapacitetet profesionale të zyrës duhet të ri definohen, profilizohen dhe rriten si për nga numri ashtu edhe për nga cilësia. Kjo ka si qëllim të vetëm interesin afatshkurtër dhe afatgjatë të kompanisë, për faktin se pothuajse çdo veprim i kompanisë në raport me palët e jashtme si operatorët hekurudhor, institucionet publike, klientët etj. duhet të ketë parasysh edhe aspektet ligjore dhe rregullative.

Krahas punëve të rregullta, zyra ligjore në vazhdimësi koordinon veprimet me departamentin e pronës dhe financave për procedimin e lëndëve në procedura përbarimore, gjykata si dhe kompletimin e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm.

5.1.1 Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për tremujorin vijues

Në tremujorin vijues INFRAKOS-in e presin kontestet gjyqësore të natyrës së njëjtë të cilat janë të ndërlidhura me pagesat e borxheve ndaj kompanisë, uzurpimin e pronës, çështjet banesore, dëmet e infrastrukturës, vërtetimin e pronave, etj. Mund të ketë edhe ndonjë kontest të ri të natyrës tjetër, por pa marrë parasysh llojin dhe numrin e kontesteve, Zyra Ligjore e INFRAKOS-it është e gatshme që me përkushtim t'i mbrojë interesat e kompanisë.

Ngritja e performancës



6. 1 Sugjerimet për ngritjen e performancës

INFRAKOS-i si Menaxher i Infrastrukturës Hekurudhore prioritetin kryesor në tremujorin e parë të këtij viti e ka pasur mirëmbajtjen e infrastrukturës ashtu që organizimi i trafikut hekurudhor të bëhet pa pengesa dhe në nivelin më të lartë të sigurisë. Sfidat me të cilat jemi përballur në këtë tremujor kanë qenë shumë të mëdha dhe akoma mbesin të tilla, përderisa të mos ndërmerren hapat e duhur nga institucionet përgjegjëse qeveritare. INFRAKOS ka qenë dhe është angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave, andaj duke ditur rëndësinë e madhe që ka hekurudha, INFRAKOS pret që edhe institucionet përkatëse të bëjnë detyrat e veta.

Si zakonisht, edhe në tremujorin e parë të këtij viti problemi numër një ndër lidhet me mos pagesën e subvencionimit të kërkuar nga Qeveria, me çka po cenohet funksionimi i kompanisë. Për këtë arsye kërkohet me urgjencën më të madhe angazhimi i menjëhershëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e problemit financiar të INFRAKOS-it. Këtu bëhet fjalë për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministrinë e Ekonomisë të cilat sipas Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063 janë përgjegjëse për nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare me INFRAKOS-in. Infracos kërkon nga këto dy ministri që të rishikojnë Draft Marrëveshjen Financiare Pesëvjeçare (2022 – 2026) të dërguar disa herë nga INFRAKOS-i dhe të bëjnë nënshkrimin e saj, ashtu që të mos cenohet funksionimi i transportit hekurudhor, ndërsa në ndërkohë të shqyrtojnë dhe miratojnë kërkesën tonë për subvencionimin e INFRAKOS-it për vitin 2022.

Duke ditur që gjendja në tremujorin e parë sa i përket të hyrave ka qenë shumë e rëndë dhe atë kryesisht pa fajin e INFRAKOS-it, sepse të hyrat kryesore të kësaj kompanie varen prej operatorëve të transportit (TRAINKOS dhe RAILTRANS), atëherë sugjerimet tona për tremujorin vijues janë si vijon:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë të realizojnë obligimet e tyre ligjore për subvencionimin e plotë të INFRAKOS-it për vitin 2022 duke i mbuluar kështu në tërësi kostot direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë të nënshkruajnë marrëveshjen financiare pesëvjeçare (2022 – 2026) e cila është hartuar në bazë të Planit shtatëvjeçar të biznesit (2022 – 2025) ;
- TRAINKOS si operator i transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave të angazhohet më shumë në rritjen e vëllimit të transportit duke ofruar kështu shërbime cilësore dhe efikase;
- Institucionet komunale dhe ato gjyqësore të angazhohen shumë më tepër në mbrojtjen e pronës së INFRAKOS-it e cila uzurpohet dhe keqpërdoret nga personat e ndryshëm fizik dhe juridik;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës njëherë e përgjithmonë të hartoj, miratoj dhe zbatoj strategji të mirëfillta zhvillimore për sektorin hekurudhor;
- INFRAKOS-i të vazhdojë me urgjencë ndërmarrjen e të gjitha masave për mbledhjen e borxheve të cilat të tjerët i kanë ndaj kësaj kompanie;
- INFRAKOS-i të vazhdojë me urgjencë reduktimin e të gjitha shpenzimeve me përjashtim të atyre të cilat janë të lidhura me sigurinë e komunikacionit hekurudhor;
- INFRAKOS-i në bashkëpunim me Bordin e Drejtorëve të bënë ristrukturimin e kompanisë;
- INFRAKOS-i të përfundoj hartimin e strategjisë zhvillimore të pronës, strategji kjo e cila është rëndësisë së veçantë për menaxhimin e mirëfilltë të pronës dhe krijimin e të hyrave;
- INFRAKOS-i të ketë angazhim maksimal në realizimin e projekteve zhvillimore të infrastrukturës hekurudhore.